



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 136 prot.

Kamëz, më 29.09 2022

V E N D I M
Nr. 116 .Datë 29/09 2022
M B I

“MIRATIMIN E SHEMBJES SË KOPËSHTIT "AZEM HAJDARI" ME ADRESË NË RRUGËN “DEMOKRACIA” (Babrru) PASKUQAN , SI REZULTAT I DËMTIMIT NGA TËRMETI I DATËS 26.11.2019”.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 29.09.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.104 Datë 28.09.2022 në mbështetje të neni 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1 nënpika 1.1 shkronja b", nenit 29 pika 1, nenit 54 shkronja “e”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar nenit 42, pika 1, shkronjat "b" dhe “d”, nenit 57 nenit 58, të Ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile”; Ligji nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme; Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”; Vendimit nr.165, datë 19.02.2020 të Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e njësisive zbatuese për projektimin, rindërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve arsimore"; Vendimit nr.26, datë 15.01.2020 të Këshillit të Ministrave "Për kryerjen e Akt-Ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara nga tërmeti"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 481, datë 30.05.2013 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, të Qarkut Tiranë"; Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 05.09.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike e shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, të Qarkut Tiranë”, si dhe referuar Akt-ekspertizës së dërguar nga Instituti i Ndërtimit me anë të shkresës nr.1463/3 prot. datë 27.09.2022, protokolluar pranë Bashkisë Kamëz me nr.8718 datë 28.09 .2022; **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e shembjes së Kopështit "*Azem Hajdari*" sipas Akt-Ekspertizës së thelluar të Institutit të Ndërtimit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Policia Bashkiake mbështet Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

4. Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, njofton 24 orë përpara ndërhyrjes për shembjen e objektit, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.

Ndërhyrja për shembjen e objektit bëhet në prani të përfaqësuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Policisë së Shtetit.

5. Për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit të kërkojë asistencën dhe bashkëpunimin e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

6. Kryetari i Bashkisë ngarkon për zbatimin e këtij vendimi, Drejtorinë e Përgjithshme të Punëve Publike, Drejtorinë e Rindërtimit, Drejtorinë e Çështjeve Ligjore, Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit, Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

7. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

